**VENDIM**
**Nr. 138, datë 20.3.1997**

**PËR ADMINISTRIMIN E DHURIMEVE FINANCIARE NGA PERSONA FIZIKË E JURIDIKË ME BANIM E SELI BRENDA DHE JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhurimet financiare nga persona fizikë e juridikë me banim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të depozitohen në dy llogari bankare të posaçme, përkatësisht në lekë dhe në valutë.

2. Përdorimi i dhurimeve të depozituara bëhet nga Ministria e Financave me autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose të Ministrit të Financave, në mungesë ose i autorizuar prej tij. Autorizimi do të lëshohet edhe në rastin e dhurimeve me destinacion, duke u mbështetur në destinacionin e përcaktuar në aktin e dhurimit.

3. Ministria e Financave të bëjë publike, nëpërmjet mjeteve të informacionit publik, numrat e llogarive të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Bashkim Fino**